



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

BORDI DREJTUES

Nr. 307 / Prot.
16

Tiranë, më 18 . 09 .2020

V E N D I M

Nr. 5 , datë 18.09 .2020

Bazuar në ligjin nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, neni 20, Bordi Drejtues i Institutit të Statistikave në mbledhjen e datës 18.09.2020

VENDOSI:

1. Të miratojë caktimin e personave përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kuvendit datë 23.07.2020 “Për vlerësimin e veprimtarisë së Institutit të Statistikave për vitin 2019” sipas Shtojcës bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETAR I BORDIT DREJTUES

ELSA DHULI



INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta”, Nd. 35, H. 1, Njesia Administrative N. 2, Tirana, Shqipëri
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300
www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Shtojcë – Për caktimin e personave për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kuvendit datë 23.07.2020 “Për vlerësimin e veprimtarisë së Institutit të Statistikave për vitin 2019”

Rekomandimin numër 1 - “Të ketë transparencë të plotë të kontributit që jep Këshilli i Statistikave në INSTAT në përmbushje të detyrimeve që i ngarkon ligji numër 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”. Të publikohen raportet e rekomandimeve të lëna nga Këshilli i Statistikave dhe aktet e miratuara nga Bordi Drejtues, duke respektuar kufizimet e legjislacionit të fushës për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale. Të publikohet pjesëmarrja e anëtarëve në çdo mbledhje dhe mënyra se si ka votuar secili anëtar.

- Ky rekomandim lidhet me Këshillin e Statistikave dhe ata duhet të japin mendimin në ç’mënyrë mendojnë ta përmbushin rekomandimin.

Rekomandimi numër 2 - “Të plotësojë sa më parë vendet vakante në pozicionet e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues për të garantuar menaxhimin e nëpunësve civilë sipas ligjit numër 152/2013 “Për nëpunësin civil

- Personi përgjegjës për këtë rekomandim është Znj. Liljana Brahja-Drejtore i Financës dhe Projekteve.

Rekomandimi numër 3 - “Të marrë masa konkrete për të reduktuar riskun e veprimtarisë statistikore që mund të shkaktohet nga rastet e fatkeqësive natyrore në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e proceseve”.

- Personat përgjegjës për këtë rekomandim janë Znj. Helda Mitre- Drejtore i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Teknologjisë së Informacionit dhe Mbledhjes së të dhënave, Znj. Alma Kondi-Drejtore i Teknologjisë së Informacionit dhe Znj. Liljana Brahja-Drejtore i Financës dhe Projekteve.

Rekomandimi numër 4 - “Të fuqizojë kapacitetet e Teknologjisë së Informacionit si në infrastrukturë ashtu edhe në staf të kualifikuar për përpunim modern të dhënash dhe prodhim statistikash cilësore”.

- Personi përgjegjës për këtë rekomandim është Znj. Alma Kondi, Drejtore i Teknologjisë së Informacionit.

Rekomandimi numër 5 – “Të vazhdojë punën për përmirësimin e pyetësorit të Censit si dhe materialeve të tjera shoqëruese, bazuar në gjetjet e Pilot Censit të kryer në vitin 2019 si dhe të përditësojë zonat në terren pas situatave të krijuara nga emergjencat e fundit që kanë ndodhur në vend”.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta”, Nd. 35, H. 1, Njesia Administrative N. 2, Tirana, Shqipëri
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300
www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- Personat përgjegjës për këtë rekomandim janë Z. Ervin Shameti- Drejtor në Drejtorinë e Statistikave Rajonale dhe Gjeoinformacionit dhe Znj. Majlinda Nesturi- Drejtor në Drejtorinë e Statistikave Sociale.

Rekomandimi numër 6 - “Të hartojë Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Censin e Bujqësisë 2022”.

- Personi përgjegjës për këtë rekomandim është Z. Denis Kristo – Drejtor në Drejtorinë e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit.

Rekomandimi numër 7 - “Të harmonizojë Strategjinë e Zhvillimit të Sistemit Kombëtar Statistikor me formatin e Strategjive të tjera Kombëtare dhe sektoriale për Sistemin e Menaxhimit të Informacionit për planifikimin e integruar IPSIS, përfshirë edhe hartimin e planit strategjik për përafrimin me acquis në fushën e statistikave, duke marrë në konsideratë edhe prioritetet e vendosura nga BE-ja në procesin e celjes së negociatave me Shqipërinë”.

- Personat përgjegjës për këtë rekomandim janë Z. Maldi Dema- Drejtor në Drejtorinë e Koordinimit dhe Çështjeve Ligjore, Znj. Vjollca Simoni –Përgjegjës në Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë dhe i Integritimit Evropian, dhe Znj. Helda Mitre- Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjishëm të Teknologjisë së Informacionit dhe Mbledhjes së të dhënave, .

Rekomandimi numër 8 - “Të finalizojë ngritjen e Komitetit të Prodhuesve të Statistikave Zyrtare, i cili është një mekanizëm i rëndësishëm për cilësinë e proceseve të planifikimit dhe ndjekjes së aktiviteteve statistikore”

- Personat përgjegjës për këtë rekomandim janë Znj. Elsa Dhuli – Zëvendëskryetare e BD dhe Z. Maldi Dema- Drejtor në Drejtorinë e Koordinimit dhe Çështjeve Ligjore.

Rekomandimi numër 9 - “Të punojë për t’iu përafruar gjithnjë e më tepër pritshmërive dhe kënaqësisë së përdoruesve të statistikave zyrtare, duke respektuar në mënyre rigoroze parimet statistikore dhe standardet ndërkombëtare nëpërmjet rritjes së edukimit statistikor dhe organizimit të takimeve formale e informale me përfaqësuesit e medias.

- Përgjegjës për këtë rekomandim është Z. Altin Xhikneli- Drejtor në Drejtorinë e Komunikimit dhe Publikimeve.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta”, Nd. 35, H. 1, Njesia Administrative N. 2, Tirana, Shqipëri
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300
www.instat.gov.al / info@instat.gov.al